

## TRYEZA E RRUMBULLAKËT

### Doracaku për përfshirjen e komunitetit në procesin e rregullimit të vendbanimeve joformale



Më vazhdën e aktiviteteve të Departamentit të Planifikimit Hapësinor/Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për parandalimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale, më 26 Nëntor të vitit 2013 u mbajtë tryeza e rrumbullakët me temën “Doracak për përfshirjen e komunitetit në procesin e rregullimit të vendbanimeve joformale” e mbështetur nga OSBE-ja misioni në Kosovë . Qëllimi i tryezës se rrumbullaket ishte t’ju shërbejë zyrtarëve komunal, planerëve urban dhe zyrtareve të zyrës së komunitetit dhe kthimit me udhëzime praktike për përfshirjen e komunitetit në procesin e rregullimit të vendbanimeve joformale , duke u bazuar në praktikatat më të mira të aplikuara deri më tani në vend dhe botë. Përmes tryzës së rrumbullaket zyrtarët komunal u inkurajuan për intensifikimin e punëve në kyqjen e komunitetit në rregullimin e vendbanimeve joformale si dhe vënies së këtij aktiviteti në krye të prioritetit, me qëllim që trajtimi i të gjitha rasteve të vendbanimeve joformale të bëhet i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm për të siguruar një zhvillim më të qëndrueshëm hapësinor në Kosovë.

Z.Shpëtim Rudi zëvendësministri i MMPH, në fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi se Doracaku mund të inicojë të menduarit kritik për praktikën e planifikimit pjesëmarrës në Kosovë, e pse jo edhe të gjeneroj qasje inovative përtej dispozitave ligjore dhe udhëzimeve të vet doracakut. Doracaku është hartuar në kuadër të aktiviteteve nga plani punës të MMPH në bashkëpunim me OSBE. MMPH dhe unë si zv.minister jemi të mendimit që përmirësimi i kushteve të jetesës arrihet përmes rregullimit të vendbanimeve joformale dhe në këtë kontekst është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm të hapsirës. Andaj mbetet obligim i yni si dhe i gjithë shoqërisë të punojmë së bashku për arritjen e këtij synimi.

Drejtori i Departamentit për Liri dhe të Drejtat e Njeriut-OSBE Z. Hjortur , çmoj lartë iden e shkëlqyer të zyrtarëve nga MMPH-ja për hartimin e doracakut për pjesëmarrjen e komunitetit. Duke aplikuar këtë doracak mendojmë se komunat do të kenë më të lehtë të organizojnë dhe të kyçin komunitetin në procesin e planifikimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale. Kosova ka ndërmarrë hapa konkret në këtë kontest si në nivelin qendror po ashtu edhe në atë lokal, mirëpo me shumë rëndësi është që të miratohet draft-Strategjia për Parandalimin dhe Rregullimin e VBJ.

Znj. Cwendoline Mennetrier, Kryesuese e Zyrës së UN-Habitatit në Kosovë , përshëndeti përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për rregullimin e VBJ dhe urojë që ky doracak të shërbejë edhe si plotësim i doracakut të vitit të kaluar .

Z.Agim Radoniqi Drejtor i Departamentit të Planifikimit Hapësinor, tha se qëllimi i doracakut është që të mbështesë komunat e Kosovës, përkatësisht Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në rregullimin e VBJ-ve në tërë teritorin e Kosovës, të ofrojë udhëzime si të hartohet plani për përfshirjen e komunitetit në trajtimin e VBJ, të shfrytëzohet si mjet i punës për planerët në përcaktimin e qasjes dhe teknikave për përfshirjen e komunitetit në rregullim edhe në rastet kur nuk mund të hartohet plani për pjesëmarrje.

Znj Suzana Goranci nga Departamenti i Planifikimit hapësinor pasi përshëndeti të pranishmit si zyrtarët komunal , shoqërinë civile, etj., një falemdërim të veçantë edhe stafit të OSBE-së dhe të DPH të cilët punuan për të realizuar këtë doracak.Në vijim u prezantua doracaku ku janë të përshkruara metoda dhe praktikatat e mira se si duhet të kyçet komuniteti në procesin e hartimit të planeve e deri te rregullimi i VBJ qysh nga faza fillestare.

Znj. Katarina Kamarinhas dhe Arjeta Himaduna nga UN-HABITAT-i prezantuan praktikatat e mira si dhe metodologjitë e përdorura gjatë tërë procesit të rregullimit të VBJ si në vendet që kanë kaluar në faza të tranzicionit e edhe praktikatat e aplikuar në Kosovë.

Në fund të takimit ju dha fjala edhe zyrtarëve nga komuna e Gjakovës dhe Mitrovicës që të na përshkruajnë praktikatat që kanë aplikuar në rregullimin e VBJ në lagjen “Koloni” dhe “Roma Mahallë”.